



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
MINISTRI

Nr. 5610/11 Prot.

Tiranë, më 28.07 2026

URDHËR

Nr. 174, datë 28.07 2026

PËR

FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LIDHJEN E MARRËVESHJES
HIDROKARBURE PËR VENDBURIMIN EKZISTUES “GORISHT-KOCUL”

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të nenit 5 të ligjit nr. 7746, datë 28.07.1993, “Për hidrokarburet (kërkimi dhe prodhimi)”, të ndryshuar; të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 279, datë 12.4.2012, “Për miratimin e listës së objekteve të operacioneve hidrokarbure, pjesë e marrëveshjes së lidhur më 26.07.1993, ndërmjet Ministrisë së Industrisë, Burimeve Minerare dhe Energjetikës (sot Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë) dhe Albpetrol-it, Bashkësisë Ekonomike të Naftës dhe Gazit (sot shoqëria “Albpetrol” sh.a.)”; i ndryshuar, si dhe të Urdhrit të Ministrit nr. 246, datë 12.3.2018, “Për miratimin e rregullores për përcaktimin e procedurave të miratimit të marrëveshjeve hidrokarbure, licencë-marrëveshjeve, si dhe të afateve përkatëse”, të ndryshuar, dhe në zbatim të objektivit për nxitjen e investimeve të huaja dhe vendase në fushën e kërkimit, zhvillimit dhe prodhimit të hidrokarbureve në territorin e Republikës së Shqipërisë, veçanërisht për vendburimet ekzistuese, si dhe për garantimin e zhvillimit të një procedure të hapur, transparente dhe konkurruese,

URDHËROJ:

- Albpetrol sh.a. të përgatisë dokumentacionin për ftesën drejtuar subjekteve të interesuara për të hyrë në Marrëveshje Hidrokarbure, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 7746, datë 28.07.1993, “Për hidrokarburet (kërkimi dhe prodhimi)”, të ndryshuar, për vendburimin ekzistues “Gorisht-Kocul”. Dokumentacioni të përfshijë formularin e aplikimit, hartën me koordinatat e vendburimit, si dhe çdo dokument tjetër të nevojshëm sipas legjislacionit në fuqi, dhe t'i paraqitet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë për miratim.

- Pas marrjes së miratimit nga MIE, Albpetrol Sh.a. të bëjë publikimin e tyre në faqen e saj të internetit. Pjesë e këtij publikimi duhet të jetë edhe vendosja e afatit të dorëzimit të aplikimit nga kompanitë e interesuara për të lidhur Marrëveshje Hidrokarbure për vendburimin ekzistuese “Gorisht-Kocul”, i cili duhet të jetë jo më pak se 90 ditë, duke filluar nga data e njoftimit.
- Dokumentacioni që do të publikohet të dërgohet në mënyrë zyrtare në MIE dhe një kopje e tij të dërgohet në adresën elektronike të saj. MIE të publikojë në faqen e saj të internetit këtë dokumentacion.
- Për zbatimin e këtij Urdhri ngarkohen Albpetrol Sh.a., si dhe Drejtoria e Programeve të Zhvillimit në Fushën e Hidrokarbureve në MIE.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR

Enea Karakaci

